



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 45 paragrafi 4, neni 46 paragrafi 2, i Ligjit Nr.03/L-048, për menaxhimin e financave publike të përgjithshme, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Br.27/2008", neni 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 21.03.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraparak, miraton këtë:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Raporti financiar i ekzekutimit dhe i administrimit të buxhetit të komunës së Dragashit për periudhën janar-dhjetor 2022.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti vjetor financiar 01 Janar 2022 deri 31 Dhjetor 2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Dragashit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhojë efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 000/01-5448-2/23

Dt. 21.03.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Uran Halimi

